



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2913 Prot.

Lezhë, më 04 . 03 . 2024

VENDIM

Nr. 19, Datë 29. 02. 2024

PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE TURISTIK, PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE KULTURORE-ARTISTIKE DHE TURISTIKE NË BASHKISË LEZHË

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1, Neni 25, Neni 54 pika k, të Ligjit nr.10352 datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, Neni 5, pika 4, në VKM nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturore dhe shpërblimin e anëtarëve të tyre”, i ndryshuar, pika 1, 2 dhe 4, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Të miratojë krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik pranë Bashkisë Lezhë i përbërë nga 5 anëtarë.

- 1- Frano Kulli
- 2- Jak Gjini
- 3- Rudina Demaliaj
- 4- Fran Laska
- 5- Ardian Mashi

2. Mandati i Këshillit artistiko-kulturor do të jetë ai i parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi.
3. Anëtarët e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik do të shpërblehen me 4 500 (katër mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje, por jo më shumë se 6 mbledhje në vit.
4. Miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore-artistike sipas lidhjes bashkëngjitur.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS

Nr. 2328 / prot.
1

Lezhë, më 23 . 02 2024

**RREGULLORE MBI FINANCIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE-ARTISTIKE DHE
TURISTIKE NË BASHKINË LEZHË**

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve kulturore-artistike dhe turistike në Bashkinë Lezhë.

Neni 2

Projektet

Projekt artistik, kulturor dhe turistik quhet çdo aktivitet që zhvillon vlera për secilën nga fushat artistike, kulturore, dhe turistike.

Neni 3

Këshilli artistiko-kulturor

1. Këshilli Bashkiak miraton ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik në Bashki.
2. Këshilli Artistiko-Kulturor dhe Turistik ngrihet dhe funksionon në përputhje me VKM nr. 540, datë 21.12.1992, ndryshuar me VKM nr. 121, dat 25.02.2005 "Për krijimin e Këshillave Artistiko- Kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre" si dhe me Udhëzimin nr.1, dt 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës, dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko-Kulturorë".
3. Anëtarët e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik që në mbledhjen e parë zgjedhin kryetarin e këtij Këshilli.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS**

Neni 4

Mbështetja nga ana e Bashkisë

1. Mbështetja e Bashkisë Lezhë për projekte artistike, kulturore dhe turistike të paraqitura nga persona fizikë e juridikë si dhe nga individë-shtetas shqiptarë në fushat e artit, kulturës, dhe turizmit që kontribuojnë në promovimin e vlerave artistike, kulturore, turistike për këto fusha, jepet në një nga format :

a) Me dhënien në përdorim të ambienteve që adminstrohen nga institucione në varësi të Bashkisë, si: salla për shfaqje, seminare, ekspozita, panaire libri etj.
b) Në mjete financiare ne formen e financimit.

2. Mbështetja financiare do jete në përputhje me projektet dhe fondet e përcaktuara për këtë qëllim nga Bashkia e Lezhës sipas miratimit nga Këshilli Bashkiak te buxhetit të vitit përkatës.

Neni 5

Aplikimi

1. Të drejtën për te aplikuar për financimin të projekteve e ka:

- çdo person fizik e juridik i regjistruar dhe që ushtron veprimtarinë në një nga fushat artistike, kulturore, dhe turistike.
- çdo individ-shtetas shqiptar.

2. Aplikimi për financim të projekteve paraqitet në formatin sipas formularit tip bashkëngjitur kësaj rregullore.

Neni. 6

Dokumentacioni për aplikim

Aplikanti, bashkëngjitur formularit të aplikimit, duhet të paraqesë pranë Bashkisë Lezhë, në 2 kopje origjinale ose të njesuara, dokumentacionin sipas rastit:

1. a) Në rastin kur aplikanti është i regjistruar si person fizik ose juridik:

Dokumentat përkatse që vertetojnë formën juridike të regjistrimit të aplikuesit si : vendimin e gjykatës/ ekstrakt të nxjerrë nga QKB

b) kopje të licensës/ve,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS

- c) rekornandim me shkrim nga personalite të shquara, shoqata të njohura, institucione, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione shtetërore të specializuara. sipas fushës që mbulon projekti i paraqitur për financim.
- ç) një përshkrim i detajuar i projektit ne mënyrë të tillë që të krijojë idenë e plotë për llojin e aktivitetit, përmbajtjen, grupmoshat që mbulon, organizimin, qëllimin dhe veçanërisht vlerat që mendohet të sjellë,
- d) preventivi i shpenzimeve të nevojshme për realizimin e projektit, i detajuar saktë ku të prezantohen edhe:
- dh) burime të tjera financiare që mbështesin financimin e projektit.
- e) mbështetja financiare që kërkohet nga Bashkia.
- i) informacion për projektet e mëparshme për ata aplikantë që kanë përfituar financim, dhe herë të tjera nga Bashkia Lezhë. Vertetim llogarie bankare pranë një banke të nivelit të dytë.
2. Në rastin kur aplikanti është individ:
- a) curriculum vitae jetë-shkrim nga personalitete të shquara ose shoqata të njohura sipas fushës që mbulon, organizimin, qëllimin dhe veçanërisht vlerat që mendohet të sjellë.
- b) preventivin e shpenzimeve të nevojshme për realizimin e projektit të detajuar saktë ku të prezantohen edhe burime të tjera financiare që mbështesin financimin e projektit
- c) mbështetja që kërkohet nga Bashkia. Informacion për projektet e mëparshme për ata aplikantë që kanë përfituar financim dhe herë të tjera nga Bashkia Lezhë.
- d) vërtetim llogarie bankare pranë një banke të nivelit të dytë.

Neni 7

Procedurat e vlerësimit dhe miratimit për financimin e projektit

1. Drejtoria e Kultures dhe Turizmit na Bashkinë Lezhë, shpall hapjen e ftesës për pjesëmarrje në realizimin e projekteve specifike të caktuar në fushën e tij.
2. Në ftesën e hapur përcaktohen qartë zërat përbërës të projektit, specifikat e realizimit të tij, si dhe fondet limit që do të përdoren për këto projekte.
3. Aplikuesi paraqet pranë bashkisë Lezhë dokumentacionin e plotë të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregullore.
4. Drejtoria e Turizmit dhe Kultures në Bashkinë Lezhë projektet e paraqitura së bashku me preventivat e tyre i kalon për vlerësim dhe miratim në Këshillin Artistiko- Kulturor.
5. Këshilli Artistiko - Kulturor dhe Turistik i shqyrton projektet, brenda një muaji nga data e dorëzimit nga Drejtoria e Turizmit dhe Kultures



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS**

6. Pas miratimit të projektit nga Këshilli Artistiko – Kulturor dhe Turistik, Drejtoria Turizmit dhe Kulturës ka për detyrë ndjekjen e zbatimit të projektit nga subjekti dhe përpilon një raport përfundimtar për kryerjen e projektit si dhe përgatit dokumentacionin për ta përcjellë tek drejtoria për likujdim të shpenzimeve.

**Neni 8
Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Lezhë.

KRYETARI

Pjerin Ndreu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS

FORMULAR APLIKIMI

PËR MBËSHTETJE TË PJESSHME APO TË PLOTË FINANCIARE

Plotësoni me kujdes këtë formular Aplikimi, sipas të gjitha udhëzimeve, duke i bashkangjitur edhe projektin e detajuar sipas sqarimeve ne faqen e fundit.

Data e ardhjes së aplikimit	
1. Titulli i Projektit _____	
2. Fusha e Projektit : Art <input type="checkbox"/> Kulture <input type="checkbox"/>	Aprovohet po <input type="checkbox"/>
Turizem <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
3. Aplikanti: _____	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS

4. Drejtuesi i Projektit : Emri: _____ Mbiemri: _____ Adresa: _____ Tel: _____ Adresa e punes : _____ Tel: _____	Shenime
5. Zerat e shpenzimeve qe kerkohen te mbeshteten nga Bashkia 5/1: _____ shuma _____ lekë 5/2: _____ shuma _____ lekë 5/3: _____ shuma _____ lekë 5/4: _____ shuma _____ lekë 5/5: _____ shuma _____ lekë 5/6: _____ shuma _____ lekë 5/7: _____ shuma _____ lekë 5/8: _____ shuma _____ lekë	Specialisti Drejtori

6. Donatorë të tjerë të projektit tuaj. Zëri i shpenzimeve të mbuluara. Shuma e dhuruar.

6/1: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____
6/2: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____
6/3: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____
6/4: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____
6/5: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS**

6/6: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____

6/7: Donatori _____ zëri i shpenzimeve _____ shuma _____

Buxheti total i projektit tuaj: _____

7. Objekti dhe qëllimi i projektit :

8. tregoni me saktësi mbështetjen nga Bashkia dy vitet e fundit.

(Projektin, shumën, datën)

8/1: Projekti _____ shuma _____ data _____

8/2: Projekti _____ shuma _____ data _____

8/3: Projekti _____ shuma _____ data _____

8/4: Projekti _____ shuma _____ data _____

8/5: Projekti _____ shuma _____ data _____

8/6: Projekti _____ shuma _____ data _____

9. Bashkëngjitur kësaj Formë-Aplikimi do të paraqisni projektin i cili duhet të jetë hartuar mbi pikat e mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS

- Titulli i projektit. Emri i Aplikuesit
- Adresa e plotë e Aplikantit
- Qellimi i Projektit
- Përshkrimi i Projektit
- Cilësoni përfituesit direkt dhe indirekt të projektit tuaj. Përdorni mundësisht statistika për interesin e publikut ndaj projektit tuaj.
- Përshkruani të renë që sjell projekti juaj në një projekt i ngjashëm me të.
- Ekipi dhe burimet njerëzore: specifikoni emrat, vendin e punës dhe funksionin e secilit pjesëtar të ekipit që do të punojë në këtë projekt.
- Specifikoni burimet dytësore për projektin tuaj në të holla apo shërbime. Si dhe kontratat apo miratimet në parim të të dytëve për ndihmë ndaj projektit tuaj.
- Paraqisni formen juridike të grupimit tuaj.
- Tregoni grafikun kohor të realizimit të projektit tuaj. Fillimi– kohëzgjatje – mbarim.
- Ndërtoni dosjen e detajuar të buxhetit të projektit tuaj. Pagesat e sakta të ekipit të këtij projekti si dhe përdorimin e të ardhurave nga ky aktivitet nëse ka të tilla.
- Bashkangjitni projektit dy referenca nga personalitete të fushes së projektit tuaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E TURIZMIT DHE KULTURËS**

Projekti duhet të jetë jo më tepër se 7 faqe.

Deklaratë e aplikuesit

Unë, _____

Në cilsinë e aplikantit dhe njëkohësisht të drejtuesit të projektit të paraqitur, deklaroj se të gjitha matërialet dhe dokumentacionet e sipërshkruara dhe të bashkangjitura janë të vërteta .

Në rast financimi të këtij projekti pranoj të gjitha kushtet e kontratës që do të lidhet me Bashkinë, për zhvillimin e projektit.

Emri _____ data _____

Nënshkrimi dhe /ose vula e aplikuesit _____

Kjo formë- aplikimi së bashku me projektin të paraqiten në :

Sektorin e informimit qytetar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

KB.
Nr 2813/ prot
dt. 12.3.24

Nr. 216/ Prot.
20

Lezhë, më 11.03.2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr .10352, datë 18.11.2020 "Për artin dhe kulturën", VKM-në nr.540, datë 21.12.1992 "Për krijimin e këshillavë artistiko-kulturore dhe shpërblimin e anëtarëve të tyre", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.19, datë 29.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor dhe turistik, për shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore-artistike dhe turistike në bashkinë Lezhë".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

